

Në bazë të nenit 35 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenit 65 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03 / L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 si dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit nr. 04 / L-155 për Sistemin e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 12/03 maj 2013) si dhe nenit 92 paragrafi 3, neni 101 paragrafi 1 si dhe nenit 114 të Ligjit nr. 04 / L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2019, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR KAPITAL RREGULLATOR DHE RUAJTJE TË FONDEVE TË KLIENTËVE TË INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKARE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton kërkesat për kapital rregullator të aplikueshme për Institucionet Financiare Jobankare-(IFJB), të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave dhe/ose emetimit të parasë elektronike.
2. Kjo Rregullore përcakton gjithashtu kërkesat për ruajtje të fondeve të klientëve që zbatohen për Institucionet Financiare Jobankare të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave dhe/ose emetimit të parasë elektronike.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Ligjin për Sistemin e Pagesave dhe/ose siç përcaktohet me poshtë për qëllimin e kësaj Rregullore:
 - 1.1. **Tepricë mesatare e parasë elektronike** – është shuma totale mesatare e detyrimeve financiare të lidhura me paranë elektronike të lëshuar në fund të çdo dite kalendarike përgjatë një gjashtëmujori, të llogaritur në ditën e parë kalendarike të muajit pasardhës të gjashtëmujorit dhe që aplikohet për muajin aktual kalendarik;
 - 1.2. **Institucion financiar jobankar (IFJB)** – person juridik i regjistruar në pajtim me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare dhe i regjistruar nga BQK-ja për kryerjen e veprimtarive të lejuara

për IFJB-të të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe kësaj rregullore.

- 1.3. **Kapitali rregullator** – nënkupton shumën e Kapitalit të klasës së parë dhe Kapitalit të klasës së dytë të përbërë nga elementet të përcaktuara në Rregullore për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave ku së paku 75% të kapitalit të klasës së parë përbëhet nga kapitali bazë i klasës së parë dhe kapitali i klasës së dytë duhet të jetë i barabartë ose më i vogël se një e treta (1/3) e kapitalit të **klasës së parë**.
- 1.4. **Klient-** nënkupton përdoruesin e shërbimit të pagesave, ashtu siç është përcaktuar në Rregulloren për regjistrimin e IFJB-ve.
- 1.5. **BQK** – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Neni 3

Kapitali minimal

Shuma minimale e kapitalit të kërkuar për regjistrim dhe e mirëmbajtur për IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave dhe/ose emetimit të parasë elektronike, duhet të jetë në pajtim me përcaktimet e nenit 4 të Rregullores për Regjistrimin e Institucioneve Financiare jobankare, sipas aktivitetit përkatës.

KAPITULLI II

IFJB-TË E REGJISTRUARA PËR USHTRIMIN E VEPRITMARISË SË SHËRBIMIT TË PAGESAVE

Neni 4

Kapitali rregullator i IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave

1. Kapitali rregullator i IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave nuk duhet të bien nën vlerën e përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregullore ose llogaritjeve të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregullore, cilado që është më e lartë.
2. Në rast ku kapitali rregullator i IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave bien nën kufijtë e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, BQK-ja, në raste të caktuara, mund t'i lejojë IFJB-së përkatëse një periudhë të kufizuar kohore në të cilën duhet të përmbushen limitet e përcaktuara.
3. Kur një IFJB përkatëse e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave i përket të njëjtit grup të një IFJB, bankë ose ndonjë entitet tjetër financiar, nuk i lejohehet përdorimi i shumëfishtë i elementeve të pranueshëm për kapital rregullator.
4. Paragrafi 3 i këtij neni zbatohet në lidhje me IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave që kryejnë veprimtari të ndryshme nga ofrimi i shërbimeve të pagesave.
5. Kur një IFJB e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave kryen edhe aktivitete tjera përveç ofrimit të shërbimit të pagesave të cilat po ashtu janë subjekt i kërkesave për kapital

rregullator, IFJB përkatëse e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave duhet të përmbushë kërkesat e tilla përveç kërkesave të përcaktuara në këtë nen.

Neni 5

Llogaritja e kapitalit rregullator të IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave

1. Pavarësisht nga kërkesat për kapital të përcaktuara në nenin 3 të kësaj rregullore, IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave, duhet të mbajnë në çdo kohë fondet e tyre të llogaritura në përputhje me njërën nga tri metodat e mëposhtme, sipas përcaktimeve të BQK-së:

1.1. Metoda A

Kapitali rregullator i IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave duhet të jenë të paktën 10% e shpenzimeve të tyre fikse të vitit paraprak. Në rastet kur IFJB e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave në datën e llogaritjes së këtij raporti të mjaftueshmërisë së kapitalit nuk ka kaluar 1 (një) vit në ushtrimin e veprimtarisë të saj, raporti llogaritet mbi bazën e shpenzimeve fikse të parashikuara në planin e biznesit për vitin e parë të operimit, të paraqitur në procesin e aplikimit për marrjen e regjistrimit si IFJB.

1.2. Metoda B

Kapitali rregullator i IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave duhet të jenë të paktën shuma e elementeve të mëposhtme të shumëzuar me faktorin e shkallëzimit “k” të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, ku shuma e pagesës - SHP (ang payment volume – VP) përfaqëson një të dymbëdhjetën pjesë (1/12) të shumës totale të transaksioneve të pagesave të kryera nga IFJB e regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave në viti paraprak:

- 1.2.1. për shumë të pagesave deri në 5 milion euro, 4.0 % e një të dymbëdhjetës pjesë të shumës totale të transaksioneve të pagesave në vitin paraprak (shuma e pagesës - SHP); plus
- 1.2.2. për shumën e pagesave nga 5 milion euro deri në 10 milion euro, 2.5 % e një të dymbëdhjetës pjesë të shumës totale të transaksioneve të pagesave në vitin paraprak (shuma e pagesës - SHP); plus
- 1.2.3. për shumën e pagesave nga 10 milion euro deri në 100 milion euro, 1.00 % e një të dymbëdhjetës pjesë të shumës totale të transaksioneve të pagesave në vitin paraprak (shuma e pagesës - SHP); plus
- 1.2.4. për shumën e pagesave nga 100 milion euro deri në 250 milion euro, 0.5 % e një të dymbëdhjetës pjesë të shumës totale të transaksioneve të pagesave në vitin paraprak (shuma e pagesës - SHP); plus
- 1.2.5. për shumën e pagesave mbi 250 milion euro, 0.25% e një të dymbëdhjetës pjesë të shumës totale të transaksioneve të pagesave në vitin paraprak (shuma e pagesës - SHP).

1.3. Metoda C

Kapitali rregullator i IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave duhet të jenë së paku vlera e treguesit relevant të përcaktuar në nënparagrafin 1.3.1 të këtij paragrafi shumëzuar me faktorin e multiplikimit të përcaktuar në nënparagrafin 1.3.2 të këtij paragrafi. dhe me faktorin e shkallëzimit “k” të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

1.3.1. treguesi relevant është shuma e elementeve të më poshtme:

1.3.1.1. të hyrat nga interesi;

1.3.1.2. shpenzimet e interesit;

1.3.1.3. të hyrat nga komisionet dhe tarifat e pranuar; dhe

1.3.1.4. të hyrat tjera operationale.

1.3.1.5. Çdo element i përcaktuar në nën-nën-nën paragrafët e nën-nën paragrafit 1.3.1 të këtij neni, duhet të përfshihen në shumën e përgjithshme të treguesit relevant me ndikimin pozitiv ose negativ. Të hyrat e jashtëzakonshme nuk do të përdoren në llogaritjen e treguesit përkatës. Shpenzimet për nënkontraktimin e shërbimeve, të kryera nga palët e treta mund të zvogëlojnë treguesin relevantë nëse shpenzimi është shkaktuar nga një subjekt i cili i nënshtrohet përcaktimeve mbikëqyrëse të kësaj rregullore. Treguesi përkatës llogaritet në bazë të të dhënave për 12 muajt e fundit të vitit të kaluar financiar. Treguesi përkatës llogaritet për vitit financiar paraprak. Kapitali rregullator i llogaritur sipas metodës C nuk duhet të bie nën 80% të mesatares së 3 viteve të mëparshme financiare për treguesin përkatës. Kur të dhënat financiare të audituara nuk janë në dispozicion, mund të përdoren të dhënat sipas IFJB-së.

1.3.2. Faktori i multiplikimit përbëhet nga:

1.3.2.1. 10%, për shumë të indikatorit relevantë të vitit paraprak deri në 2.5 milion euro;

1.3.2.2. 8%, për shumë të indikatorit relevantë të vitit paraprak nga 2.5 milion euro deri në 5 milion euro;

1.3.2.3. 6%, për shumë të indikatorit relevantë të vitit paraprak nga 5 milion euro deri në 25 milion euro;

1.3.2.4. 3%, për shumë të indikatorit relevantë të vitit paraprak nga 25 milion euro deri në 50 milion euro;

1.3.2.5. 1.5%, për shumë të indikatorit relevantë të vitit paraprak mbi 50 milion euro.

2. Faktori i shkallëzimit “k” i përdorur në Metodën B dhe C është:

2.1. 0.5, për IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave, të cilat ushtrojnë vetëm shërbime të pagesave për jashtë vendit (transfere me jashtë);

2.2. 1, për IFJB-të e tjera të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave.

3. Metoda A e përcaktuar në paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të këtij neni aplikohet për llogaritjen e kapitalit rregullator në vitin e parë pas regjistrimit të IFJB-së për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave.

4. Metoda B e përcaktuar në paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të këtij neni aplikohet për IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave. Kjo metodë fillon të aplikohet pasi që IFJB e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave ka përfunduar një vitit të plotë financiar të operimit.

5. Metoda C e përcaktuar në paragrafin 1 nën paragrafi 1.3 të këtij neni aplikohet për IFJB-të të cilat përveç regjistrimit për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave dhe ose emetimit të parasë elektronike, angazhohet edhe në veprimtarinë e dhënies së kredive.

Neni 6

Kërkesat për ruajtje të fondeve për IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave

1. IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave duhet të mbrojnë të gjitha fondet që janë marrë nga klientë të shërbimit të pagesave ose nëpërmjet një ofruesi tjetër të shërbimeve të pagesave për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave, sipas mënyrës së mëposhtme:
 - 1.1. Fondet nuk duhet të bashkohen (përzihen) në asnjë moment, me fondet e ndonjë personi fizik ose juridik tjetër nga klienti, për llogari të të cilit fondet mbahen.
 - 1.2. Nëse fondet e pranuar mbahen ende nga IFJB e regjistruar të ushtrijë veprimtarinë e shërbimit të pagesave dhe nuk i ka dorëzuar tek përfituesi ose nuk janë transferuar në një bankë ose IFJB tjetër të licencuar /regjistruar të ushtrijë veprimtarinë e shërbimit të pagesave deri në fund të ditës së punës pas ditës kur fondet janë pranuar, ato duhet të depozitohen në një llogari të veçantë në një bankë.
 - 1.3. Fondet e pranuar duhet të jenë të mbrojtura nga kërkesat e kreditorëve të tjerë të IFJB-së së regjistruar të ushtrijë veprimtarinë e shërbimit të pagesave, veçanërisht në rast të paaftësisë paguese;

KAPITULLI III

IFJB-TË E REGJISTRUARA PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË EMETIMIT TË PARASË ELEKTRONIKE

Neni 7

Kapitali rregullator i IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike

1. Kapitali rregullator i IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike, nuk duhet të bien nën shumën e kapitalit të përcaktuar në nenin 3 apo shumën e kapitalit të llogaritura sipas përcaktimeve të nenit 8 të kësaj rregullore, cilado që është më e lartë.
2. Në rast se kapitali rregullator i IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike bien nën limitet e vendosura në paragrafin 1 të këtij neni, BQK-ja, në raste të caktuara, mund t'i lejojë IFJB-së përkatëse një periudhë të kufizuar kohore në të cilën duhet të përmbushen limitet e përcaktuara.
3. Nëse IFJB përkatëse e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike i përket të njëjtit grup të një IFJB, bankë ose ndonjë entitet tjetër financiar, nuk i lejohet përdorimi i shumëfishtë i elementeve të pranueshëm për kapital rregullator.
4. Paragrafi 3 i këtij neni zbatohet në lidhje me IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike që kryejnë veprimtari të ndryshme nga emetimit i parasë elektronike dhe/ose ofrimi i shërbimeve të pagesave.
5. Kur një IFJB e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike kryen edhe aktivitete tjera përveç emetimit të parasë elektronike dhe/ose ofrimit të shërbimit të pagesave të cilat po ashtu janë subjekt i kërkesave për kapital rregullator, IFJB përkatëse e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike duhet të përmbushë kërkesat e tilla përveç kërkesave të përcaktuara në këtë nen.

Neni 8

Llogaritja e kapitalit rregullator të IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike

1. Kapitali rregullator i IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike në çdo kohë duhet të jetë i barabartë ose më i lartë se shuma që rezulton nga plotësimi i kërkesave të përcaktuara në paragrafët e mëposhtëm.
2. Kapitali rregullator i IFJB-ve të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike duhet të jetë të paktën 2% e tepicës mesatare të parasë elektronike.
3. Për IFJB-të e regjistruara të cilat përveç emetimit të parasë elektronike ushtrojnë edhe veprimtarinë e shërbimit të pagesave, llogaritja e kapitalit rregullator për veprimtarinë e shërbimit të pagesave bëhet në përputhje me njërin nga tri metodat e përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregullore, ndërsa llogaritja e kapitalit rregullator për veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike bëhet në përputhje me përcaktimet e paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 9

Kërkesat për ruajtje të fondeve për IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike

1. IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike duhet të ruajnë fondet që janë marrë në këmbim të parave elektronike të emetuara, sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregullore.
2. Për IFJB-të e regjistruara të cilat përveç emetimit të parasë elektronike ushtrojnë edhe veprimtarinë e shërbimit të pagesave, përveç përcaktimeve të këtij neni aplikohet edhe dispozitat e nenit 6 të kësaj rregullore.
3. Fondet e marra në formën e pagesës përmes instrumentit të pagesës nuk duhet të ruhen derisa ato të kreditohen në llogarinë e IFJB-së së regjistruar për ushtrimin e emetimit të parasë elektronike ose nëse janë vënë në dispozicion të IFJB-së së regjistruar për ushtrimin e emetimit të parasë elektronike në përputhje me kërkesat ligjore apo rregullative për kohën e ekzekutimit të transaksioneve të pagesave. Në çdo rast, fondet e tilla duhet të ruhen jo më vonë se pesë ditë pune pas datës së emetimit të parave elektronike.
4. IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike duhet t'a informojnë paraprakisht BQK-në për çdo ndryshim të rëndësishëm për ruajtje të fondeve.

KAPTIULLI IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 10

Shkeljet, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregullore do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkimeve administrative, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Ligjin për

Bankat, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare si dhe Ligjin për Sistemin e Pagesave.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2020.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës